



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 241, datë 27.10.2020

**“PËR MIRATIMIN E RELACIONIT MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE
FIGURËS TË KANDIDATIT PËR T’U PRANUAR NË PROGRAMIN E FORMIMIT
FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS,
NË VITIN AKADEMIK 2020-2021,
Z. BLENDAR BALA”**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159, pika 2/a dhe 161, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Seksionit VI dhe Seksionit VII, të Vendimit nr. 171, datë 27.9.2019 “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, si dhe pasi u njoh me Relacionin “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatit për Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2020-2021, z. Bledar Bala”, të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Relacionit mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatit z. Bledar Bala, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidatit për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, në vitin akademik 2020-2021.
3. Të njoftohet për këtë vendim z. Bledar Bala dhe Shkolla e Magjistraturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR

GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR

ALFRED BALLA

ANËTAR

ANËTAR

ANËTAR

KOSTAQ BELURI

BUJAR SHESHI

NURIHAN SEITI

ANËTAR

ANËTAR

ANËTAR

SANDËR BECI

VATË STAKA

TARTAR BAZAJ

ANËTAR

ESMERALDA KESHI